



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 11 prill 2018

Numri i lëndës: 2016-35

Ndërmarrja Hoteliere Turistike Iliria Deçan

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 prill 2018, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Z. Jorge MARTINS RIBEIRO, anëtar zëvendësues

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 6 dhjetor 2016.
2. Ankesa ka të bëjë me procedurat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjensinë Kosovare të Privatizimit ("Dhoma e Posaçme") dhe subjekte të tjera.
3. Znj. Bednarek është anëtare e Panelit dhe gjithashtu gjykatëse e EULEX-it në këtë Dhomë të Posaçme. Prandaj ajo është tërhequr nga kjo lëndë, për shkak të paraqitjes së konfliktit të interesit dhe ajo nuk ka

marrë pjesë në shqyrtimin e lëndës, në përputhje me Rregullën 12(1)(1) të Rregullores së Punës së Panelit. Ajo është zëvendësuar nga z. Jorge Martins Ribeiro, anëtar zëvendësues i Panelit.

II. FAKTET

4. Ankuesi ka paraqitur parashtrësia faktike të gjëra dhe të hollësishme lidhur me natyrën e kësaj çështjeje. Paneli ka shqyrtuar të gjithë informacionin përkatës të parashtruar. Megjithatë, me qëllim që të sigurohet saktësia dhe qartësia, Paneli ka kufizuar paraqitjen e fakteve të rastit në ato që janë përkatëse lidhur me zgjidhjen e kësaj lënde.
5. Faktet e lëndës siç janë parashtruar nga ankuesi dhe siç duken nga dokumentet në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si më poshtë:
6. Ankuesi është një Ndërmarrje Shoqërore (NSH) që gjendet në Deçan.
7. Më 28 qershor 1946, ish Republika Socialiste e Jugosllavisë kishte shpronësuar disa parcela toke nga Manastiri i Deçanit (Manastiri).
8. Më 5 nëntor 1997, Qeveria e Republikës së Serbisë i kishte dhuruar përsëri një pjesë të tokës së shpronësuar Manastirit. Parcelat në fjalë ishin në pronësi të ankuesit dhe një tjetër NSH-je, APIKO. Kjo rezultoi në paraqitjen e kërkesës pranë gjykatave në prill të vitit 2000 kundër Manastirit nga ankuesi dhe APIKO. Procesi gjyqësor në lidhje me këtë çështje ka vazhduar deri në vitin 2008, kur përfundimisht ishte parashtruar pranë Dhomës së Posaçme. Procedurat kanë vazhduar më pas përfshirë edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjensinë Kosovare të Privatizimit, e cila rezultoi me krijimin e Dhomave të Specializuara të Dhomës së Posaçme, ku ishte trajtuar lënda. Në këtë kontekst, Dhomat e Posaçme kanë lëshuar vendime të njëpasnjëshme gjatë gjithë procedurës.
9. Çështja në fund u parashtrua pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës më 3 nëntor 2015, atëherë kur Manastiri i Deçanit kishte dorëzuar një kërkesë në atë gjykatë, duke kërkuar shqyrtimin e kushtetutshmërisë të vendimeve të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme.
10. Më 20 maj 2016, Gjykata Kushtetuese ka lëshuar aktgjykim në këtë çështje. Paneli ka konstatuar se kërkesa ishte e pranueshme dhe se kishte pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu Gjykata Kushtetuese ka shpallur të dy vendimet e apeluara të pavlefshme dhe ka vendosur që aktgjykimet e mëparshme rreth pronësisë nga Kolegji i Dhomës së Posaçme të datës 27 dhjetor 2012 janë përfundimtare dhe të detyrueshme.

11. Më 31 tetor 2016, Gjykata Kushtetuese ka shpallur kërkesën e mëtejshme të ankuesit dhe të APIKO-së për shqyrtimin e "ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë" të aktgjykimit të datës 20 maj 2016 të papranueshme.

III. ANKESAT

12. Ankuesi pohon se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese ishte i padrejtë dhe në kundërshtim me rendin juridik të Kosovës. Ai pretendon se ka shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. LIGJI

13. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
14. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29, në lidhje me rregullën 25 të rregullores së punës.
15. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
16. Paneli thekson që ankesa e ankuesit ka të bëjë me procedurat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjensinë Kosovare të Privatizimit dhe pranë Gjykatës Kushtetuese.
17. Sipas Rregullës 25 paragrafi 1, bazuar në Konceptin e Llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli në parim nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Nuk ka juridiksion qoftë në aspektin administrativ e as në atë gjyqësor të punës së gjykatave të Kosovës në ndonjë nivel. Rrjedhimisht, Paneli nuk mund të ndikojë ose të ndryshojë rezultatin e procedurave gjyqësore. Edhe kur gjykatësit e EULEX-it marrin pjesë në procedurat që zhvillohen pranë gjykatave të Kosovës, si në këtë lëndë, ky fakt nuk ia humb asaj gjykate karakterin e të qenurit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih, ndër të tjera, PShDNj, Z.A. kundër EULEX-it, 2014-36, 29 shkurt 2016, paragrafi 17, K.P.

kundër EULEX-it, 2014-31, 21 prill 2015, paragrafi 13, Gani Zeka kundër EULEX-it, 2013-15, 4 shkurt 2014, paragrafi 13).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese